



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.430/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjore Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Thaçit, nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Malishevë,, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.A.nr.430/2017, Bajram Thaçit, nga radhët e subjektit politik LVV, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Bajram Thaçi, i njëjti ka theksuar se zyrja e Komisionit Komunal Zgjedhor KKZ në Malishevë ka qenë e mbyllur gjithë ditën dhe nuk kemi pasur qasje në dokumente të FPR dhe FRK. Në qendrat e votimit ku dyshojmë se ka pasur pa rregullsi janë në Fshatin Lladrovc, QV 3031A/02. Më tutje thekson se, sipas pohimeve të njërit prej votuesve, ai ka votuar për kandidatin me nr.7 Agnesa Kastrati, mirëpo votat e saj nuk figurojnë në formular, duke shtuar se një pretendim i tillë ka edhe për votat e kandidatit me nr.18, i njëjti ka marrë pohimin se familjari i tij ka votuar në njërën nga pikat e vendvotimit në Malishevë, sepse vota e tij nuk figuron në formularë. Ankuesi nga pretendimet e lartëcekura ankimore, PZAP-it i ka kërkuar që të mundësohet qasja në dokumente zyrtare në FPR dhe FRK, duke kërkuar që të hapen kutit e votimit në fshatin Mleqan QV 3001A, në fshatin Drenoc QV 3008A, në fshatin Golluboc QV 3044A, në fshatin Llapqevë QV 3037A, në fshatin Terpeze QV 3012A, në fshatin Kervasari QV 3039A, në fshatin Bellanice QV3028A, në fshatin Lladroc QV 3031A 02D, në fshatin Banje QV 3032A, në fshatin Lubizhde QV 3020, në fshatin Mirushe QV 3051A, në fshatin Malishevë QV 3016A, në fshatin Carralluke QV 3036A.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë përkitazi me pa rregullsit e votave në fshatin Mleqan QV 3001A, në fshatin Drenoc QV 3008A, në fshatin Golluboc QV 3044A, në fshatin Llapqevë QV 3037A, në fshatin Terpeze QV 3012A, në fshatin Kervasari QV 3039A, në fshatin Bellanice QV3028A, në fshatin Lladroc QV 3031A 02D, në fshatin Banje QV 3032A, në fshatin Lubizhde QV 3020, në fshatin Mirushe QV 3051A, në fshatin Malishevë QV 3016A, në fshatin Carralluke QV 3036A, për shkak të pa rregullsive, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Bajram Thaçit, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.403/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.